



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 628/11 Prot.

Tiranë, më 23.04.2021

VENDIM
Nr. 69, datë 23.04.2021

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË KURRIKULAVE

Në zbatim të neneve 38 (pika1, germa “i”), 46 (pika 3) të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, të neneve 20 (germa “n”), 26 (pika 3, germa “ç”) të Statutit të UST- së, në nenin 10 të Rregullores së UST-së, Senati Akademik i UST-së në mbledhjen e dates 23.04.2021,

VENDOSI:

1. Të ngrihet komisioni i përhershëm institucional, KOMISIONI I KURRIKULAVE, në Universitetin e Sporteve të Tiranës me këtë përbërje:
 - 1(një) anëtar, i cili vjen nga rradhët e studentëve;
 - 1(një) anëtar, i cili vjen nga rradhët e përfaqësuesve të njësisë që mbulon zyrën për zhvillimin e kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë;
 - 3 (tre) anëtarë të këtij komisioni të cilët duhet t’i përkasin kategorisë “Profesor”, vijnë nga rradhët e stafit akademik.
2. Të hapë thirrjen për vetëkandidimin e personelit akademik si dhe anëtarit student për këtë komision.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. AGRON KASA

